

## Workshop me temë: “Industria e Turizmit dhe Profesionet e së Ardhmes”

Elite Travel Group dhe Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumni-t zhvilluan aktivitetin për studentët me temë: “Industria e Turizmit dhe Profesionet e së Ardhmes”.

Përfaqësueset e Elite Travel Group, Znj.Adriana Kotherja, Drejtore në Departamentin e Kontratave si edhe Znj.Valbona Lleshi, Drejtor në Departamentin e Burimeve Njerëzore zhvilluan një bashkëbisedim me studentët rreth njohurive që ata kishin për këtë agjenci dhe për shërbimet që ajo ofron. Mes të tjerash, Znj.Kotherja, shpalosi para studentëve në mënyrë statistikore një listë me profesionet më të kërkuara në tregun e sotshëm të punës.

Studentëve iu bë thirrje të të përfitojnë nga takime dhe aktivitete të tilla me qëllim njohjen më nga afër të tregut të punës, për profilin që ata kanë zgjedhur të studiojnë.

Ata u ftuan të marrin pjesë në projektet e shumta që agjencia zhvillon dhe vazhdimisht të aplikojnë për vendet e reja të punës që ajo ofron.

Nga studentët e vitit të fundit u kërkua të diskutohet mundësia për të zhvilluar praktikat mësimore pranë kësaj kompanie.



